

***Listën e Vendimeve të aprovuara në mbledhjen e I-r (Parë) të Rregullt e Kuvendit të Komunës
Kaçanik, mbajtur me 29 Janar 2021;***

1. Vendim për miratimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 104/02-2048/21;
2. Vendim për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-2016/20;
3. Vendim për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-2259/21;
4. Vendim për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2021 / Lënda: 01Nr.60/01-2256/21.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-2048/21
Kaçanik, 29.01.2021

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenet 17 dhe 40.2(d) të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 2.1, 6.2 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 29 Janar 2021, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021, i propozuar nga Kryetari i Komunës.
2. Në Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës janë paraqitur; synimet dhe objektivat e Kryetarit të Komunës, Drejtorive komunale dhe Njësitë e Zyrave të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë me Zyrën e Kryetarit të Komunës, dhe mënyra e realizimit të tyre.
3. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës përmban numër të protokollit 01Nr.104/02-2048/21 është përmbledhur në gjithsej 77 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e Planit të Punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2021, do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë përkatëse komunale.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoritë Komunale; dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kerem Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-2016/21
Kaçanik: 29.01.2021

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 40.2 (d) të ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Janar 2021, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KOMITETIT PËR
KOMUNITETE PËR VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete, për vitin 2021, i propozuar nga Komiteti për Komunitete, me tekstin e mëtejme, "Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021".
2. Në Planin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021, janë paraqitur objektivat e këtij Komiteti, arsyeshmëria e tyre, adresimi, përkrahja e nevojshme dhe koha e implementimit të aktiviteteve.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është : Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2021 01Nr. 60/01-2016/21, i përmbledhur në gjithsej, 6 faqe.
4. Për realizimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete do të kujdeset; Komiteti për Komunitete dhe organet tjera relevante të komunës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Komunitete dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mëseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-2259/21
Kaçanik, 29.01.2021

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 40.2 (d) të ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Janar 2021 mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME
PUBLIKE, PËR VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike, për vitin 2021, i propozuar nga Komiteti për Shërbime Publike i Kuvendit të Komunës.
2. Në Planin e Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021, janë paraqitur, objektivat e këtij Komiteti, numri i mbledhjeve dhe periudhat e mbajtjes së mbledhjeve.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike, i përmbledhur në gjithsej, 2 faqe, Lënda : 01 Nr. 60/01-2256/21.
4. Për zbatimin e Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike do të kujdeset: Komiteti për Shërbime Publike dhe organet tjera relevante të komunës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Komiteti për Shërbime Publike, Kryetari i Komunës, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Merseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.60/01-2256/21
Kaçanik: 29.01.2021

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 40.2 (d) të ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Janar 2021, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV
PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2021, i propozuar nga ky Komitet Konsultativ.
2. Në Planin e Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (KKPAK) janë paraqitur objektivat që parashihen t'i realizoj ky komitet në mbledhje të rregullta dhe aktivitete të tjera, treguesit, mjetet e verifikimit, institucionet zbatuese dhe afatet kohore të realizimit.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është: Plani i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2021 i përmbledhur në gjithsej 8 faqe/ Lënda: 01Nr.60/01-2256/21.
4. Për realizimin e Planit të Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, do të kujdeset KKPAK dhe organet tjera relevante të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Merseli

